



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 10, Datë 05.05.2015

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT FITUES TË KONKURSIT NDËRKOMBËTAR PËR  
PROJEKTIMIN URBAN TË “VIJËS BREGDETARE TË JUGUT DHE  
VENDBANIMEVE PËRRETH - RIVIERËS”

Në mbështetje të neneve 17, 27 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për Përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, si dhe në vijim të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 14, datë 07.03.2014 “Për miratimin e nismës për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e projekteve fituese të tre loteve, të Konkursit Ndërkombëtar për projektimin urban të “Perlës së Bregdetit të Jugut”, si më poshtë:
  - a. Loti 1: “Projekti i rehabilitimit të shkallareve të Qytetit të Sarandës i kombinuar me krijimin e "anekseve" si hapësira publike” dhe rehabilitimi i segmentit të shëtitorës kryesore ekzistuese ku krijohet lidhja e shkallareve;
  - b. Loti 2: “Projekti i rehabilitimit të segmentit qendror të Vijës Bregdetare të Qytetit të Himarës” dhe platforme panoramike për hedhje me parashutë nga mali i Llogarasë;
  - c. Loti 3: Projekti i rehabilitimit të Orikumit:
    - “Pika A - Projekti arkitektonik i pikës së mirëseardhjes në Orikum”;
    - “Projekti i rehabilitimit të Bulevardit të Orikumit”;
    - “Pika B - Projekti arkitektonik i krijimit të “Info Point Orikum”;
    - “Projekti i rehabilitimit të rrugës së Kishës së Marmiroit, Orikum”;
    - “Pika C - Projekti arkitektonik i krijimit të “Info Point Kisha Marmiroit”;
    - “Pika D - Projekti arkitektonik i një sheshi publik pranë bregut.

2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
  - a. Harta e planvendosjes, kufijve dhe strategjisë së zhvillimit për territoret e përfshira në Lot 1 (6 kopje).
  - b. Harta e planvendosjes, kufijve dhe strategjisë së zhvillimit për territoret e përfshira në Lot 2 (6 kopje).
  - c. Harta e planvendosjes, kufijve dhe strategjisë së zhvillimit për territoret e përfshira në Lot 3 (6 kopje).
3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit të organizojnë dhe drejtojnë punën për zbatimin e projekteve fitues.
4. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Bashkia Vlorë, Bashkia Himarë dhe Bashkia Sarandë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

*Adelina Greca*



**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**